



Sulmohet me armë zjarri policia kufitare në Ujman

KRONIKA | August 06, 2022 - 15:53

SHPËRNDAJE:  


Rreth 10 herë sot është shtënë drejt zyrtarëve të policisë kufitare derisa ata po kryenin detyrën e tyre zyrtare, kontrollën rutinore në Liqenin e Ujmanit.

Kështu ka njoftuar Xhelal Sveçla, ministër i Mbrojtjes i Kosovës.

Ai shtoi se "grupet ilegale serbe të cilat tashmë po mbrohen dhe mbështeten edhe publikisht nga struktura të caktuara serbe, po bëjnë përpjekje maksimale të na pengojnë apo ndalojnë të kryejmë detyrën tonë brenda vendit tonë".

"Gjuajtja me armë drejt zyrtarit policor është sulm ndaj institucionit kryesor të shtetit. Për më pak se 1 javë, 2 herë strukturat kriminale kanë shtënë drejt zyrtarëve policorë për t'i penguar ose për t'i vrarë ata. Ne mbesim të angazhuar me të gjitha kapacitetet tona që t'i kryejmë detyrat tona që na obligon ligji e Kushtetuta jonë. Për asnjë kusht nuk do të tërhiqemi nga e drejta jonë, pavarësisht çdo sulmi të organizuar apo orkestruar nga kriminelë që ju pengon puna jonë në çdo cep të Republikës së Kosovës", ka theksuar Sveçla. /Zëri

Të rekomanduara



Sulmohet me armë zjarri policia kufitare në...

August 06, 2022



Ushtroi dhunë në familje, arrestohet lipjanasi...

August 05, 2022

Vdes një person në Bogë, u godit nga një kamion me beton

KRONIKA | August 04, 2022

Arrestohet 39-vjeçari që kanosi zyrtarët policorë gjatë një seance gjyqësore në Ferizaj

KRONIKA | August 04, 2022

Mashtronin mërgimtarët me bileta, arrestohen bashkëpronarët e "Prishtina Jet"

KRONIKA | August 04, 2022

Sulmoi seksualisht një femër nga Moldavia, arrestohet vitiasi

KRONIKA | August 04, 2022

Paraburgim gjilanasit që shfrytëzoi për prostitucion një femër me probleme psikike

KRONIKA | August 03, 2022

Sulmoi dy roje pyjesh në Kaçanik, arrestohet 56-vjeçari

KRONIKA | August 03, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | August 06, 2022

Dyshohet për një të vrarë dhe dy të plagosur në Lipjan



KRONIKA | August 04, 2022

Mashtronin mërgimtarët me bileta, arrestohen bashkëpronarët e "Prishtina Jet"



KRONIKA | August 06, 2022

Policia jep detaje për vrasjen e mbrëmshme në Lipjan



KRONIKA | August 04, 2022

Vdes një person në Bogë, u godit nga një kamion me beton



KRONIKA | August 05, 2022

Goditet për vdekje nga vetura këmbësori 19-vjeçar në Prishtinë



KRONIKA | August 04, 2022

Voziti 124 km/h në zonën e 40 km/h, vushtrriasi gjobitet me 500 euro